Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0935

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092), në përbërje nga: Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik (OE) "Creative Design" N.T.SH. lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull:"Furnizim me emblema per Njesine Speciale - ritender"me nr. të prokurimit:"214-23-11565-1-3-6", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Policia e Kosoves, me datën 15.01.2024, mori këtë:

Vendim

1. Refuzohet, si e pa bazuar ankesa e operatorit ekonomik"Creative Design" N.T.SH. , e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 24.11.2023 (me numër protokolli 935/23), vendimi i AK lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me emblema per Njesine Speciale - ritender " me nr. të prokurimit: "214-23-11565-1-3-6", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Policia e Kosoves, mbetet në fuqi.

2. Konfiskohet shuma e mjeteve të depozituara në emrin e tarifës ankimore dhe të njëjtat kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës, sikurse parashihet me 31 pika 5, të Rregullores së Punëssë OSHP, lidhur me nenin 118 të LPP.

Arsyetim

- ***Faktet dhe rrethanat procedurale*** –

Me 23.10.2023, Policia e Kosoves , në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me emblema per Njesine Speciale - ritender" me nr. të prokurimit: "214-23-11565-1-3-6". Nderkaq me datën 06.11.2023 eshte publikuar njoftimi mbi vendimin e AK. Ku është rekomanduar për kontratë Operatori Ekonomik "Rroni" SH.P.K.

OE “Creative Design” N.T.SH. me datën 10.11.2023 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK. AK- Policia e Kosoves merr vendim qe te refuzohet si e pa bazuar kërkesa per ri-shqyrtim e OE “Creative Design” N.T.SH. lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me emblema per Njesine Speciale - ritender” me numër te prokurimit: "214-23-11565-1-3-6" inicuar nga Autoriteti Kontraktues.

I pakënaqur me vendimin e AK-së, OE ankues “Creative Design” N.T.SH. me datën 24.11.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër të protokollit 935/23, kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, lloji i kontratës:furnizim, vlera e parashikuar e kontratës:9,930,00 €.

Organi Shqyrtues i Prokurimit i ka njoftuar palet me raportin e ekspertizes ku dhe, Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

- Mbi fazën e shqyrtimit paraprak –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me ketë, me 08.12.2023 eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE“Creative Design” N.T.SH. tëaprovohetsi pjeserisht e bazuar,të anulohet njoftimit mbi vendimin AK dhe lënda të kthehet në Ri-vlerësim.

Paneli Shqyrtues konsideroi se lidhur me cështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1, të Rregullores së Punës së OSHP, përderisa pretendimet e palëve, provat, parashtresat e tyre dhe ekspertriza e ekspertit shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftushme për të vendosur ne aspektin meritor.

PËRMBLEDHJE DHE PERGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES

Eksperti shqyrtues, pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon:

Pretendimi nr. 1

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, bazuar ne aneksin 1

te FDT-se (dosjes se tenderit) , arsyetimi nga OE ankues ne ankesën tij dhe fotografimi i matjeve te mostrave nga vete OE ankues, shihet qarte se te:

LOGO NJSI, IEDD dhe K9, nuk kane diametrin 8 cm, përveç **LOGO NJSO** e cila ka diametrin është 8 cm, prandaj AK – Komisioni i vlerësimit me rastin e eliminimit te OE ankues (është praktik e mire gjate vlerësimit te mostrave te prezantoj fakte dhe dëshmi si p.sh. foto, etj.,,) ka vepruar sipas nenit 59 par. 4 të LPP-së, ku thotë: "Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit".
Prandaj, duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këto pika nuk janë të qëndrueshëm. .
Pretendimi nr. 2
Lidhur me pretendimin ne këtë aktivitet te prokurimit te operatorit ekonomik ankues, lidhur me pretendimet se mostrat e dorëzuar nga OE i rekomanduar per kontrate nuk janë as per se afërmi sipas kërkesë se autoriteti kontraktues ne Aneksit 1 te FDT-se, ne kemi vendosur disa dallime te mostrave te OE te rekomanduar per dhënie nga ato te kërkuara nga autoriteti kontraktues.
Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, bazuar ne dëshmitë, faktet e prezantuara nga OE ankues përmes fotografive me ngjyra vërehen qarte se janë disa dallimesh p.sh.:
TEK LOGO NJSI – ngjyra (por AK ka prezantuar dy logo njëra me ngjyre te gjelbër ushtarake ndërsa, tjera me dy ngjyra qe janë me te hapura), kurse rrethi brendshëm nuk ka qene kërkesë te qëndiset me penj (edhe pse ne specifikim ka qene kërkesë po citoj: "Rrethi duhet jete i qëndisur" pa specifikuar se cili rreth i jashtëm apo edhe rrethi i brendshëm), shkronja vërehen se nuk janë te madhësisë se kërkuar nga autoriteti kontraktues janë më të mëdha;
TEK LOGO NJSO, ngjyrat nuk i posedon sikurse ka kërkuar autoriteti kontraktues ne Aneksin 1 te FDT-së, pasi qe vërehen janë me te hapura, shqiponja vërehër se është shumë e mbyllët nga ajo që ka kërkuar AK, kurse per formën ovale OE ankues nuk ka ofruar dëshmi duke matur gjatës por vetëm përmes fotove që nuk mund te argumentohet ky pretendim;
TEK LOGO K9 – harta është më e madhe se sa kërkesa e autoriteti kontraktues, qeni dallon tek veshët, dhe ngjyra e qenit është ma e mbyllët nuk dallohë/shihën sytë
TEK LOGO e PK-së, tek mostra e prezantuar nga OE i rekomanduar per kontrate, dallon ngjyra, dhe vërehet se hapsira e këndeve është pak sa më engushtë se sa ajo që AK ka prezantuar.
TEK FLAMURI I KOSOVES - tek mostara e prezantuar nga OE i rekomanduar per kontrate, dallon ngjyrat, thurja skajeve te flamurit dallon, si dhe po ashtu dallon ngjyra;
Duke marr për bazë se pretendimet ankimore kanë te bëjnë me mostrat e prezantuar nga OE, atëherë sipas nenit 59 te LPP-se, si dhe nenit 37 te Rregullores nr. 001/2022 per Prokurimi Publik, ku vlerësimi është ne diskrecion te AK-së – sepse eksperti po te shikoj apo inspektoj mostrat atëherë ndërhyn ne përgjegjësin/kompetencat e AK, mirëpo ekspeti bazohet ne faktet dhe dëshmitë e prezantuar nga OE ankues (sqarim: AK te inspektoj me kujdes mostrat dhe te respektoj nenin 59 të LPP-se, dhe nëse asnjë nga OE nuk arrin te kaloj inspektimin e mostrave ashtu siç janë kërkuar nga AK, atëherë te veproj sipas nenit 62 të LPP-së) prandaj eksperti sqaron se AK – komisioni i vlerësimit nuk ka vepruar sipas nenit 59 par. 4 të LPP-së, ku thotë: "Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve".
Prandaj, duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë sepretendimi i palës në ankese në këto pika janë pjesërisht të qëndrueshëm.

Pretendimi nr. 3
Lidhur me pretendimin ne këtë aktivitet te prokurimit te operatorit ekonomik ankues,se kur analizohet vendimi per refuzimin e kërkesës per rishqyrtim shihet se AK-ja per secilin pretendim tonin ankimor kundrejt OE te rekomanduar per kontrate .
Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, OE ankues përmes platformës elektronike e- prokurim ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim me kurse ZPP i AK-së përmes platformës elektronike e-prokurim nxjerr vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, duke vepruar ne pajtim te plotë me nenin 108/A par. 9 te LPP-se, ku thotë: "Refuzimi do tëarsyetohet dhe do ti komunikohen me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë." si dhe nenin 108/A par. 12 te LPP-se, ku thotë: Kundërshtimet dhe vendimet e miratuara në përputhje me paragrafët 8 dhe 10 të këtij neni, duhet të jenë të arsyetuara dhe ti komunikohen me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesësdhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë", mirëpo bazuar ne vendimin mbi refuzimin e kërkesës per rishqyrtim, nuk janë bindëse dhe as te argumentuar ne gjuhen e fakteve dhe argumenteve - provave apo te bazuar ne dispozita ligjore te LPP-se, por me shume i ngjanë një përshkrimi, duke mos arritur te argumentohet e kundërta e pretendimeve te OE ankues, me fakte dhe argument konkrete dhe bindëse, mirëpo një gjë e tillë nuk ka ndodhur as nga komisioni i vlerësimit ne raportin e tij dhe as ne vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim nga ZPP, andaj duke u bazuar ne këto fakte dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këto pika janë pjesërisht të qëndrueshëm.
Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, AK – komisioni i vlerësimit, nuk ka respektuar nenin 7, 59, 60, të LPP-së, andaj Është përgjegjësi, dhe në Autoritetit Kontraktues, respektivisht komisionit të vlerësimit – ZPP, që procesi i vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të behet ne harmoni te plote me dispozitat ligjore te LPP-se, ne këtë aktivitet te prokurimit, ne mënyrë qe të respektohen kërkesat e përzgjedhjes, specifikimet teknike Aneksi 1 dhe Aneksin 7 ne dosje te tenderit si dhe te respektohen kriteret e dhënies.
Eksperti shqyrtues sqaron, se autoritetet kontraktues janë te obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike te përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marr në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP- së, autoriteti kontraktues duhet te këtë ne konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është te siguroj mënyrën më efikas, më transparent dhe më të drejt tëshfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike.
Ne mungesë te provave te paraqiutra lidhur me mostrat e operatorit ekonomik ankues (N.T.SH." CREATIVE DESIGN) ne cilesin e ekspertit shqyrtues nuk mundemi qe te konstatojm se i njeti (O.E N.T.SH." CREATIVE DESIGN) ai ploteson kriterin e mostrave apo jo andaj si rezultat i kësaj edhe rekomandojmë qe proecdura te kthehet ne rivlersim.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.
Paneli shqyrtues vlerëson se raporti i ekspertizës i përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale,

rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit dhe parimet dhe interesin publik. Paneli shqyrtues do të ndalet vetëm tek pretendimi kryesor dhe përcaktues sa i përket vendimarrjes.
Nisur nga fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 104 dhe me nenin 105 të LPP. Paneli shqyrtues fillimisht do të ndalet tek pohimi ankimore i ankuesit rreth eleminimit të tij/saj ku sipas AK, ankuesi është i papërgjegjshëm për shkak se LOGO K-9 nuk e ka ngjyrën ashtu siç është kërkuar tek Aneksi 1 -Specifikimit teknik ku, është kërkuar që Fillimi i rrethit të emblemës me ngjyrë të kaltër e mbyllët ndërsa mostra e dorëzuar LOGO K-9 ka ngjyrë të zezë. Është fakt se autoriteti kontraktues tek letra standarde e eleminimit nuk e ka shkruajtur fjalën "zezë", por këtë e ka përmirësuar AK në përgjigjen e kërkesën për ri-shqyrtim dhe ka pranuar se ka qenë një lëshim teknik dhe tani ankuesi me ankesën në OSHP në vend që të ofroj prova dhe fakte bindëse për panelin për të provuar përgjegjshmërinë e tij dhe të kundërtën e asaj që AK ka konstatuar, ankuesi deklaron se "*arsyeja e autoritetit kontraktues është e paqartë dhe e pakuptueshme për ne për faktin se në arsyetimin e eleminimit nuk shënohet fare se çfarë gabimi ka mostra jonë*". Kështu që, në mungesë të provave paneli shqyrtues pretendimin e kualifikon si të pabazuar dhe ankuesi mbetet i eleminuar për këtë aktivitet të prokurimit.

Tutje, ankuesi me ankesën e tij ka kontestuar edhe vendimin e AK lidhur me OE të rekomanduar për kontratë, me çrast ka ofruar fotografi të mostrave të OE të rekomanduar për kontratë dhe fotografi të mostrave të kërkuara me Dosje të Tenderit nga AK. Eksperti shqyrtues këto pretendime i klasifikon si pjesërisht të qëndrueshme duke deklaruar se sipas nenit 59 të LPP si dhe nenit 37 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, vlerësimi është në diskrecion të AK, në të kundërtën eksperti nuk mund të ndërhyjë në inspektim të mostrave sepse është në përgjegjësi/kompetencë të AK, me çrast rekomandon që AK gjatë vlerësimit nëse asnjëra ofertë aarin të kaloj inspektimin e mostrave mund të veprojë edhe në bazë të nenit 62 (anulimin e aktivitetit të prokurimit). Paneli shqyrtues duke u gjendur në një situatë ku eksperti shqyrtues mbështetet në dispozitat ligjore të lartëcekura dhe nuk nxjerrë asnjë konstatim lidhur me këtë atëherë, paneli shqyrtues vendos ti jep të drejtë AK dhe që ta lë në fuqi vendimin e AK, vendim ky i cili është nxjerrë nga një komision i vlerësimit i cili supozohet të jetë profesional, sepse AK më së miri i di nevojat e saja dhe për panelin shqyrtues është edhe jo parimore që ky aktivitet të prolongohet edhe më tutje, kur është i ditur fakti se ky aktivitet i prokurimit është i përsëritur (ri-tenderuar) për shkak se njëherë është anuluar me vendimet paraprake të OSHP Nr. 2023/0505 dhe 2023/0506 për shkak që AK nuk ka hartuar Dosjen e Tenderit mirë, duke mos bërë saktë specifikimin teknik të mostrave. Andaj në ndajshtesë të lartcekurave, Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht ne pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret është përgjegjës që të vendos se a ka pasur të drejtë për përzgjedhjen e OE të rekomanduar për dhënie të kontratës bazuar edhe në neni 24 paragrafi 2 të LPP cituar ”Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj”.
Kthimi i një aktivitetit të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore në ri-vlerësim, nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat

personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji".
Prandaj duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu dhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, Paneli Shqyrtues mori në konsideratë të gjitha pohimet e ankuesit, aktet dhe veprimet e ndërmarra nga AK, raportin e ekspertit shqyrtues dhe i analizoi me kujdes të gjitha shkresat e kësaj lënde dhe konsideron se pohimi ankimor i OE ankues është i pabazuar dhe refuzohet, ashtu siç janë dhënë në konstatimet e panelit.

Paneli shqyrtues në këtë vendim marrje ka pasur ne konsideratë edhe kërkesat e nenit 104, paragrafi 4 të LPP, sipas të OSHP duhet të veprojë sa më shpejtë që të jetë e mundshme, të veprojë në mënyrë proporcionale me shkeljen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa, dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **POLICIA E KOSOVËS**
- OE - **N.T.SH." CREATIVE DESIGN "**
- Arkivës së OSHP-së: